



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, Rregulloren (QRK) nr.12/2020 Për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, nxjerr:

V E N D I M

Neni 1

Shërbimet e Komunës, fushëveprimi i të cilave ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve për qytetarë, angazhohen të punojnë edhe gjatë ditëve të vikendit, ditën e shtunë dhe të diel.

Neni 2

Organizimi i punës dhe angazhimi i stafit bëhet nga Drejtorët e Drejtorive përkatëse në bashkëpunim me Zyrën e Personelit, në përputhje me kushtet dhe kriteret e parapara me Rregulloren (QRK) nr.12/2020 Për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë.

Neni 3

Angazhimi i shërbimeve sipas këtij vendimi bëhet për shkak të rritjes së vëllimit të kërkesave dhe punëve me rastin e ardhjes së bashkatdhetarëve tanë nga diaspora.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe vlen deri më 08.01.2021.

U dërgohet:
Drejtorëve të Drejtorive
Zyrës së personelit
Arkivit

Nr. 02-016/01-0077805/20
Podujevë, 23 dhjetor 2020

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi

